



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 05, datë 13.01.2022

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 196, DATË 22.09.2021
“MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
KRYESOR TË SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SH.P.K., NËPËRMJET SHITJES SË
100% TË KUOTAVE TË SAJ”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 164/2 prot., datë 29.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.09.2021 “Mbi dhënieën e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 196, datë 22.09.2021, vendosi:
 1. Dhënieën e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k., nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj.
 2. Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
 3. Shoqëria “ENERGY PLUS” sh.p.k. nuk çlirohet nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet e tjera për këtë transferim, nëse kjo kërkohet nga këto organe.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimarrje me shkresën nr. 838/7 prot., datë 27.09.2021.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 0709/2334 prot., datë 16.12.2021, shoqëria ka depozituar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të saj, ku janë reflektuar ndryshimet përkatëse, siç përcaktuar dhe në autorizimin e ERE-s.
- Me depozitim të këtij dokumenti rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.09.2021.

- Në nenin 113 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 196, datë 22.09.2021 “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k. nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave të saj”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI